



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2371/4 prot

Datë 20.12.2021

V E N D I M

Nr. 1016/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.12.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-08756-10-19-2021, me objekt “*Sistemim asfaltim rruga e fshtatit Qinam, Nj.A Zall Herr*”, me fond limit 80,820,393 (*tetëdhjetë milionë e tetëqind e njëzetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues: “Company Riviera 2008” SHPK
Rruga Nationale Kamëz-Fushë Krujë, kthesa e Valiasit nr. 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë
Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë

Subjekti i Interesuar: “Bami” SHPK
Rruga Kamas , Fushë Krujë, Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.10.2021, është publikuar në SPE procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-08756-10-19-2021, me objekt “Sistemim asfaltim rruga e fshtatit Qinam, Nj.A Zall Herr”, me fond limit 80,820,393 (tetëdhjetë milionë e tetëqind e njëzetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 04.11.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 22.11.2021, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

"SHKELQIMI 07"	42,230,000.00	I skualifikuar
COMPANY RIVIERA 2008	42,379,455.00	I skualifikuar
EUROTEOREMA PEQIN	44,000,000.00	I skualifikuar
K.M.K	44,616,515.00	I skualifikuar
DAJTI PARK 2007	45,821,158.45	I skualifikuar
DENIS-05	46,422,314.45	I skualifikuar
L.T.E CONSTRUCTION	47,808,635.00	I skualifikuar
NIKA	47,935,366.11	I skualifikuar
ARDMIR	48,126,706.12	I skualifikuar
BEQIRI	49,928,244.72	I skualifikuar
GLAVENICA	50,192,771.00	I skualifikuar
ALMO KONSTRUKSION	50,422,747.00	I skualifikuar
BAMI	50,461,743.00	I kualifikuar
BE - IS SH.P.K	51,190,637.00	I skualifikuar
BESTA	51,290,610.00	I skualifikuar
KUPA	51,424,907.90	I kualifikuar
VARAKU E	52,176,537.00	I skualifikuar
NDREGJONI	54,553,672.00	I kualifikuar
B-93	55,023,606.00	I kualifikuar
SHPRESA - AL	55,984,755.00	I kualifikuar
LIQENI VII	56,323,306.66	I kualifikuar
VELLEZERIT HYSA	56,549,105.57	I kualifikuar
PEPA GROUP GROUP	56,793,901.30	I kualifikuar
Shendelli	58,677,967.00	I skualifikuar
INERTI	58,913,942.88	I kualifikuar
SENKA	58,981,481.00	I skualifikuar
ARB & TRANS-2010	58,998,886.90	I kualifikuar
EURONDERTIMI 2000	59,951,819.00	I skualifikuar
INFINIT	63,787,490.00	I skualifikuar
STERKAJ	63,951,906.90	I kualifikuar
BIBA-X	67,890,925.00	I skualifikuar
ALB TIEFBAU	69,594,415.00	I skualifikuar
AGI KONS	79,310,844.17	I skualifikuar

II.4. Në datën 22.11.2021 operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, sipas argumentimi/arsyetimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

• *Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat sipas shtojcës 8, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit pjesa II, deklarata A. DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT janë të paplotësuara.*

II.5. Në datën 23.11.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 171, me datë 01.12.2021.

II.6. Nga verifikimet e kryera, konstatohet se në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 171, me datë 01.12.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar njoftimi i fituesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton fitues operatori ekonomik “Bami” SHPK.

II.7. Në datën 01.12.2021, operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2371/2 Prot., date 02.12.2021, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 47813/2 prot., datë 09.12.2021, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 2371/3 prot., datë 13.12.2021, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK dhe me shkresën me datë 09.12.2021, e ka njoftuar atë, se ka vendosur **mospranimin e ankesës**.

II.11. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe në sistemin e ankesave elektronike, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen : “[...]Në datën 22.11.2021, ora 14:56 në sistemin e prokurimit publik, në rrugë elektronike ka mbërritur në rubrikën mesazhe, njoftimi me vlerësimin për tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim rruga e fshatit Qinam, Nj,A. Zall Herr” si dhe arsyet e skualifikimit të ofertës së dhënë nga shoqëria jonë “Company Riviera 2008” SHPK. Sipas autoritetit kontraktor, arsyet e skualifikimit të ofertës tonë janë: Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat sipas shtojcës 8, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit pjesa II, deklarata A. DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT janë të paplotësuara.

Më datë 23.11.2021 në sistemin e prokurimit elektronik është publikuar Formulari i Njoftimit të fituesit nga Bashkia Tiranë. Referuar arsyes së parashtruar nga autoriteti kontraktor për skualifikim, sqarojmë se nuk jemi dakord dhe e kundërshtojmë vendimin e autoritetit kontraktor sepse skualifikimi është i padrejtë dhe i paligjshëm dhe për këtë arsye po paraqesim ankesë pranë autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Bazuar në ligjin 162/2020 dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik” kundërshtojmë vendimin e autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë në lidhje me arsyen e skualifikimit se:

- Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesat sipas shtojcës 8, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit pjesa II, deklarata A. DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT janë të paplotësuara.

Për të përmbushur këtë kriter, operatori ekonomik “Riviera company 2008” SHPK ka paraqitur Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik, sipas shtojcës 8, të dokumenteve standarde të tenderit, të publikuara nga autoriteti kontraktor, ku ka plotësuar të gjithë të dhënat e mundshme për rastet kur të dhënat janë të aksesueshme në mënyrë elektronike për autoritetin kontraktor siç parashikohet në pikën 1 të LPP.

Sipas shtojcës 8 Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit, pika A-Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar shumë qartë që referencat për këto lloj deklaratash do të bëhen vetëm në rastet kur janë të zbatueshme, nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutem tregoni. Pra, siç është mëse e kuptueshme ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto dokumente mbështetëse, e para në baza të aksesueshme të dhënash shtetërore (nëse është i disponueshëm) dhe e dyta duke kërkuar sqarime dhe dokumente mbështetës nga ofertuesi/operatori ekonomik kur e shikon të arsyeshme. Nuk mund të jetë kriter skualifikimi për operatorët ekonomikë nëse nuk ka paraqitur burimin e dokumentacionit përkatës të deklaruar në shtojcën 8 të DST, kur një dokumentacion i tillë nuk vërtetohet nga baza të aksesueshme të dhënash shtetërore (në formë elektronike) nga autoriteti kontraktor, pasi këto lloj dokumentesh nuk mund të merren kurrësi nga baza të aksesueshme të dhënash shtetërore nga autoriteti kontraktor, por janë dokumente që tërhiqen vetëm me firmë dhe vulë të njomë ose elektronike nga sistemi e-albania nga persona të autorizuar të shoqërisë tonë për të marrë këtë lloj informacioni.

Autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë nuk na ka kërkuar asnjë informacion apo sqarim në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, dhe në rastin konkret autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë nuk na ka kërkuar asnjë sqarim, argument apo dokumente mbështetëse për arritjen e një përfundimi të saktë që “Company Riviera 2008” SHPK nuk plotëson këtë kriter. “Company Riviera 2008” SHPK me plotësimin, firmosjen e vulosjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, në të cilën deklarojmë se jemi në rregull më çdo deklaratë dhe dokumentacion, e përmbush këtë kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë. Pra arsyeja e skualifikimit nuk qëndron dhe është në kundërshtim të plotë me ligjin e LPP dhe me VKM. Bazuar në LPP dhe VKM, ju sqarojmë se për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbush kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike e profesionale me dokumentacionin e paraqitur dhe të deklaruar sipas shtojcës nr. 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit dhe nuk duhet të ketë si qëllim në vetvete skualifikimin e operatorëve ekonomikë duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme dhe sipërfaqësore. “Company Riviera 2008” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e APP dhe të deklaruara në shtojcën nr. 8 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit ka dëshmuar, vërtetuar, se plotëson të gjitha kriteret që të jetë i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi. Duke skualifikuar në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin shoqërorin “Company Riviera 2008” SHPK e cila ka paraqitur ofertën më të ulët se operatori ekonomik i shpallur fitues, ju si autoritet kontraktor i shkaktoni buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 8,082,288 lekë pa TVSH, në lidhje me këtë dëm ekonomik që po shkaktoni buxhetit të shtetit Shqiptar do vëmë në dijeni edhe KLSH. Misur nga ato që u thanë më sipër, arsyeja e skualifikimit të shoqërisë “Company Riviera 2008” SHPK është e pabazuar në ligj dhe prova dhe për rrjedhojë nuk qëndron, prandaj e kundërshtojmë vendimin për skualifikim dhe përfundimisht kërkojmë nga ana juaj si autoritet kontraktor të shqyrtoni ankesën tonë me seriozitet, jo në mënyrë të njëanshme dhe sipërfaqësore dhe të merrni një vendim të drejtë duke kualifikuar operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, në të kundërt bazuar në ligjin dhe në prova do të vazhdojmë me të gjitha hapat e nevojshëm deri në marrjen e një vendimi të drejtë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 7

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

si dhe në

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se ankimues “Company Riviera 2008” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

-Formularin e përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8) nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK.

III.1.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.*

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të LPP-së përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash

6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion

ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Pra, kriteret e përgjithshme të kualifikimit duhet të përmbushen, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8). Autoriteti kontraktor ka skualifikuar këtë operator ekonomik me arsyetimin se nuk ka plotësuar të gjitha rubrikat e Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë informacion në arsyetimin e tij për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues, se cilat rubrika nuk ka plotësuar në Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton se, nga operatori ekonomik ankimues në dorëzimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme, për rastet kur të dhënat janë të aksesueshme në mënyrë elektronike nga autoriteti kontraktor, siç parashikohet në dispozitat e sipërcituara në fushën e prokurimit publik. Për më tepër, autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo informacion në përputhje me pikën 7 të nenit 26 të VKM i ndryshuar, sipas së cilës në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, dhe në rastin konkret autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë nuk ka kërkuar asnjë sqarim apo dokumente mbështetëse për këto sqarime për arritjen e një përfundimi të saktë, që operatori ekonomik ankimues nuk e plotëson këtë kriter.

Gjithashtu, sipas shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, Pjesa II, Pika A-Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, është përcaktuar që

referencat për këto lloj deklaratash do të bëhen **në rastet kur janë të zbatueshme**: “Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni”. Pra, Komisioni gjykon, se ka dy mënyra se si autoriteti kontraktor mund të marrë këto deklarata, e para në bazë të të dhënave të aksesueshme shtetërore nëse është i disponueshëm dhe e dyta duke kërkuar sqarime dhe dokumente mbështetëse ofertuesve kur e shikon të arsyeshme. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural ku ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesave për sqarim dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-08756-10-19-2021, me objekt “Sistemim asfaltim rruga e fshtatit Qinam, Nj.A Zall Herr”, me fond limit 80,820,393 (tetëdhjetë milionë e tetëqind e njëzetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj
Kryetar		
Jonaid Myzyri		